



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM  
Nr.58, Datë 29.01.2020

PËR  
KORRIGJIMIN E GABIMIT NË SHKRIM NË VENDIMIN NR. 31, DATË 23.01.2020,  
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, kryesisht, pasi konstatoi gabimin në shkrim të numrit në shkronjën “d”, pika 1, të Vendimit të tij nr. 31, datë 23.01.2020, “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021”,

**VENDOSI:**

1. Korrigjimin e gabimit në shkrim të numrit në shkronjën “d”, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 31, datë 23.01.2020, “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021”, si më poshtë:

“d) Në rast se, në renditjen përfundimtare të testimit profesional ka konkurrentë mbi numrin **75 (shtatëdhjetë e pesë)**, që sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës kanë arritur pikët e nevojshme për kandidatët për magjistratë, kuotat e planifikuara në pikën 1, shkronja “b” mund t’i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve për magjistratë, të profilit gjyqtar. Në çdo rast numri i kandidatëve të shtuar për magjistratë, të cilët kanë aplikuar për profilin gjyqtar, nuk mund të kalojë numrin e planifikuar sipas pikës 1, shkronja “b” të këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**